



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 503, datë 13.09.2024

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT DHE PWRCAKTIMI I NIVELIT TW VLERËSIMIT
PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. Njohuritë ligjore.

1.A.A. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën, apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e prokurorit, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura*

novit curia” – “Gjykata e nje ligjin”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor, në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo nje mirë parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor dhe zbaton ato në praktikë, por rralë përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së lartë (shihni dokumentet 2 e 3). Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsyet për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke i dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes (shihni dosjet 1 e 2). Në çështjet penale, i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal dhe alternativat e tij (shihni dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 3 e 4). Gjithashtu, ajo ka njohuri të mira dhe për caktimin e masave të sigurimit personal (shihni dosjen 5). Rezulton se ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit, në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Nje aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e gjer tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Konstatohet gjithashtu se për 3 dokumentet e përzgjedhura dhe 5 dosjet e vëzhguara është ushtruar ankim nga palët dhe janë lënë në fuqi nga gjykimi në shkallën e dytë (shihni dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3, 4 e 5)”.*

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Rezulton se gjyqtarja përpara përcaktimit të fakteve të çështjes pasqyron procedurën e ndjekur dhe vendimet e marra në funksion të zbatimit të saj. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në të cilën, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) shqyrtimin e kërkesave të

të pandehurve për gjykim të shkurtuar,¹ (ii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin, shtimin, apo saktësimin e objektit të padisë,² etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Faktet e çështjes në çdo rast janë paraqitur në mënyrë kronologjike, duke integruar në përmbajtje të tyre, edhe provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet fakti konkret, si dhe duke cituar në disa raste edhe pjesë të përmbajtjes së provave shkresore apo në raste të veçanta edhe të provave të tjera, sikurse është ekspertimi.

Referuar llojit të vendimit, penal apo civil, rezulton si më poshtë;

Në vendimet gjyqësore penale, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli ose kërkesë penale*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja i kushton rëndësi përcaktimit të detajuar të fakteve të çështjes dhe përshkrimit të tyre në një ose disa pjesë të arsytimit të vendimit, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo natyrës së gjykimit sipas kërkesës objekt shqyrtimi.

Në vendimet e themelit gjyqtarja, nxjerr faktet e provuara nga tërësia e provave të administruara në gjykim, duke përshkruar fillimisht kronologjinë e ngjarjes, gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, si dhe veprimet e kryera nga i pandehuri, duke i integruar provat mbi të cilat mbështeten faktet. Elementë të faktit penal, bëhen pjesë e analizës së elementëve të figurës së veprës penale, duke i kushtuar një rëndësi specifike paraqitjes dhe listimit të fakteve thelbësore mbi të cilat mbështetet analiza e provave dhe kualifikimi ligjor.

Në shtatë vendimet gjyqësore penale themeli të analizuarra³, nëpërmjet të cilave është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi i të pandehurit, gjyqtarja evidenton dhe analizon faktet të cilat ndikojnë në individualizimin e dënimit.

Në çështjen penale me objekt “*Deklarimin e parashkrimit të ekzekutimit dhe shuarjes së dënimit që ai përmban, si dhe urdhërimi i mosekzekutimit për vendimin penal nr. 85 datë 22.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ndryshuar ...*”,⁴ faktet e çështjes janë evidentuar në mënyrë përshkruese në nënndarjen e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese, duke renditur në mënyrë kronologjike rrethanat e faktit të dënimit penal dhe procedurat ligjore të ndjekura për ekstradimin si dhe ekzekutimin e në Shqipëri, ashtu sikurse i kanë rezultuar gjykatës gjatë gjykimit. Në nënndarjen e dytë është përshkruar vlerësimi i gjykatës duke evidentuar dhe analizuar rrethanat e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit penal sipas legjislacionit italian, sipas marrëveshjes dypalëshe.

¹Në të gjitha vendimet penale të cilat janë shqyrtuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar.

²Vendimet nr.70(152), datë 05.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³ Vendimet nr. 139 datë 28.04.2016; nr. 220 datë 28.05.2015; nr. 391 (2360) datë 16.11.2015; nr. 382 (1973) datë 16.12.2014; nr. 225 (1961) datë 21.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁴ Vendimi nr. 50, datë 03.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Në çështjen penale me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal”⁵, faktet gjenden të pasqyruara në mënyrë kronologjike në një pjesë të evidentueshme të pjesës përshkruese-arsyetuese, pas së cilave gjyqtarja parashtron vlerësimet për shkaqet e posaçme dhe të dhënat që përlligjin masën e sigurimit të kërkuar nga organi i akuzës, duke mbërritur në përfundimin se i përshtatet kriterëve të parashikuara në nenin 238 të K.Pr.Penale.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, në *vendimet gjyqësore civile dhe familjare* të analizuara, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka parashtruar në mënyrë të detajuar faktet e çështjes, në një pjesë të veçantë dhe të dallueshme të pjesës përshkruese arsyetuese. Paraqitja e fakteve të çështjes, duke iu referuar vendimeve të përzgjedhura me short, bëhet duke iu referuar përmbajtjes së provave të administruara në gjykim si dhe shpjegimeve të palëve, duke i vlerësuar ato dhe si pohime gjyqësore. Gjithashtu, evidentohet se faktet e çështjet të përshkruara në pjesën e rrethanave të faktit, gjenden më pas të analizuara në raport me ligjit tek nëndarja e vlerësimit ligjor të gjykatës mbi kërkesëpadinë, pjesë në të cilën analizohen provat mbi të cilat mbështeten dhe provohen faktet e çështjes. Analiza e rrethanave të faktit bëhet në mënyrë të qartë, të plotë dhe mbi bazën e një rendi kronologjik dhe logjik. Provat e paraqitura nga palët nuk parashtrohen të ndara në vendim, por janë të integruara dhe të evidentueshme kur referohen pretendimet e tyre në mbështetje të rrethanave të faktit.

Sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik civil apo penal, vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes, në të gjitha vendimet gjyqësore të nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, familjar, gjykim penal themeli apo kërkesë penale*) rrethanat e fakteve parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, pasi më parë është evidentuar procedura e ndjekur. Evidentohet një analizë e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Në të gjitha vendimet gjyqësore konstatohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile, të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

- Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja përcakton natyrën e marrëdhënies juridike, për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse

⁵ Vendimi nr. 302, datë 26.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtarja përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një marrëdhënie detyrimi etj.*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale apo natyrën e kërkesës penale (*kërkesë për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit apo parashkrimin e ekzekutimit të dënimit penal*). Rëndësia e duhur nga ana e gjyqtares, i jepet përcaktimit të saktë, të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Në shumicën e vendimeve, në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese, gjyqtarja analizon juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re se natyra juridike e çështjes është evidentuar pothuajse në të gjitha çështjet e trajtuara, por edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike, në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Referuar burimeve të vlerësimit, në këtë aspekt, evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore, objekt vlerësimi në dy kategori (*i*) vendime civile/familjare dhe (*ii*) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

(*i*) Në vendimet gjyqësore civile (*përmbushje detyrimi, pasaktësi dokumentash, zgjidhje martese*), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, por edhe ligjeve organike përkatëse që gjejnë zbatim në rastin konkret, nga ku evidentohet më konkretisht :

- a) Në vendimet gjyqësore me objekt “Zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj”, gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (*nenin 132, 133, 134, 146/1 të K.Familjes*) në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve, si dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj⁶. Gjithashtu, gjyqtarja referon dhe arsyeton në lidhje me përgjegjësinë prindërore pas zgjidhjes së martesës, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, nenet 3, 5, 215 të K.Familjes, si dhe mbi detyrimin e prindit që nuk i është lënë fëmija për kontribut, bazuar në nenet

⁶ Vendimet nr. 352 datë 06.05.2016; nr. 113 datë 21.02.2014; nr. 649 datë 22.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

158, 161 të K.Familjes. Gjyqtarja referon dhe nenin 3 të Konventës së OKB-së “Mbi të drejtat e fëmijëve”⁷;

- b) Në vendimin gjyqësor me objekt “Detyrim për lidhje kontrate të energjisë elektrike” gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitat materiale nenet 716, 772, 608, 609, 640 të K.Civil, në lidhje me detyrimin që lind nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor për një organ të administratës publike, përcaktimin e dëmit pasuror dhe kur pala mund të detyrohet për një dëm, në lidhje me përkufizimin e furnizimit si kontratë, në lidhje me përgjegjësitë e shitësit etj.⁸

Në vendimet gjyqësore civile, evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht identifikohen :

- a) Nenet 36, 41, 42, 51 të K.Pr.Civile lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes;
- b) Nenin 32 të K.Pr.Civile në lidhje me detyrimin që ka pala pretenduese për barrën e provës; nenin 262 të K.Pr.Civile mbi fuqinë e plotë provuese të provave/dokumentave, konkretisht të shkresës private, e cila përbën provë vetëm në rastin kur paraqitet nga pala kundërshtarë⁹;
- c) Nenin 185 të K.Pr.Civile në lidhje me vendimmarrjen mbi kërkesat për ndryshimin e objektit të padisë; nenet 201/1, 299/b të K.Pr.Civile në lidhje me arsyetimin e pushimit të gjykimit për kërkimin e palës në kushtet kur ka hequr dorë vetë nga gjykimi i padisë¹⁰;
- d) Nenet 158, 158/a/1 të K.Pr.Civile, nenet 25 dhe 134 të K.Familjes lidhur me veprimet përgatitore dhe zhvillimin e seancës së pajtimit;

(ii) Në vendimet gjyqësore penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal. Konkretisht identifikohen :

- a) Neni 134/2 i K.Penal, në lidhje me akuzën “Vjedhja” më shumë se një herë¹¹; neni 137/1 i K.Penal, në lidhje me akuzën “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”¹²; neni 290/2 i K.Penal në lidhje me akuzën “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”¹³; neni 291 i K.Penal në lidhje me akuzën “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” duke iu referuar edhe dispozitave konkrete të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë¹⁴; neni 84 i K.Penal në lidhje me akuzën “Kanosja”, neni 278 i K.Penal në lidhje me akuzën “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, neni 283/1 i K.Penal, në lidhje me akuzën

⁷ Vendimi nr. 649 datë 22.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁸ Vendimi nr. 712 datë 11.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁹ Vendimi nr. 712 datë 11.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹⁰ Vendimi nr. 712 datë 11.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹¹ Vendimi nr. 4 datë 15.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹² Vendimi nr. 382 datë 16.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹³ Vendimi nr. 101 datë 02.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹⁴ Vendimet nr. 225 datë 21.11.2013 dhe nr. 101 datë 02.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

*“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”*¹⁵; neni 78/1 i K.Penal në lidhje me akuzën *“Vrasja me paramendim”*, neni 278/2 i K.Penal në lidhje me akuzën *“Mbajtja pa leje e armëve luftarake”*¹⁶; neni 259 i K.Penal në lidhje me akuzën *“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”* duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore sipas vendimit unifikues nr. 284 datë 06.10.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, neni 248 i K.Penal në lidhje me akuzën *“Shpërdorimi i detyrës”*, neni 245/1 i K.Penal në lidhje me akuzën *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*¹⁷.

- b) Kushtet kumulative që veprimet e paligjshme të kualifikohen në nenin 82 të K.Penal në lidhje me akuzën *“Vrasja me dashje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”*¹⁸;
- c) Neni 68 i K.Penal në lidhje me institutin e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit penal¹⁹, duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore sipas vendimit unifikues nr. 7 datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me afatin e parashkrimit të ekzekutimit;
- d) Në ato raste kur për cilësimin juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit dhe me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij, nevojitet referimi në ligje të tjera organike, identifikohet ligji organik përkatës. Konkretisht, në analizën e figurës së veprës penale *“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”*, gjyqtarja në funksion të analizës së veprimeve të kryera nga i pandehuri në kundërshtim me ligjin, referon nenin 2 të Ligjit nr. 99/2013 *“Për armët”* apo ndryshimet ligjore të dispozitës penale materiale me Ligjin 98/2014 datë 31.07.2014²⁰. Në analizën e figurës së veprës penale *“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*, gjyqtarja identifikon dhe analizon nenet 26, 54, 60 të Ligjit nr. 69 datë 21.06.2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*²¹;
- e) Në të gjitha rastet, referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me subjektin e veprës penale, fajin si element i domosdoshëm i anës subjektive të veprës penale (*neni 12 i K.Penal*), apo në lidhje me caktimin dhe individualizimin e dënimit (*nenet 48, 49, 50 të K.Penal*) apo edhe aplikimin e dënimeve alternative e plotësuese (*nenet 30, 37, 59 të K.Penal*). Gjithashtu, në rastet kur procedohet për disa vepra penale, referohet neni 55 i K.Penal në lidhje me institutin e bashkimit të disa dënimeve, në një të vetëm.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtarja referon, si pjesë të integruar të arsyetimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal, konkretisht :

¹⁵ Vendimi nr. 391 datë 16.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹⁶ Vendimi nr. 139 datë 28.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹⁷ Vendimi nr. 220 datë 28.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹⁸ Vendimi nr. 139 datë 28.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹⁹ Vendimi nr. 50 datë 03.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

²⁰ Vendimi nr. 391 datë 16.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

²¹ Vendimi nr. 220 datë 28.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

- a) nenet 13, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, lidhur me përcaktimin e përbërjes së trupit gjykues, juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes²²;
- b) nenin 376 të K.Pr.Penale lidhur me akuzën e re të komunikuar në procesin penal, dhënien kohë të pandehurit për të mbajtur qëndrim, në respektim të të drejtave ligjore të tij²³;
- c) nenin 470 të K.Pr.Penale lidhur me kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale;
- d) nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale, lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me masën e caktimit të dënimit, në rastet e procedimit me këtë lloj gjykimi të posaçëm, nenin 152/1 lidhur me çmuarjen e provave sipas bindjes së krijuar nga shqyrtimi i tyre në tërësi;
- e) nenin 190/1 të K.Pr.Penale, lidhur me disponimin për provat materiale; nenin 485 të K.Pr.Penale, lidhur me shpenzimet gjyqësore në procesin penal;
- f) nenet 251, 252, 258, 259 të K.Pr.Penale lidhur me analizimin e konceptit të arrestimit në flagrancë, në vendimin me objekt “*Vleftësim të ligjshëm arrestimi në flagrancë dhe caktim mase sigurimi*”; Gjithashtu, gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim konkretisht nenet 228, 229, 230, 238 të K.Pr.Penale, në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit²⁴;

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm, edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 9 të Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar” miratuar nga shteti shqiptar me Ligjin nr. 8499 datë 29.06.1999 në vendimet penale vazhdimin e ekzekutimit²⁵;
- nenet 2, 4 të Marrëveshjes shtesë të Konventës Europiane të datës 21 mars 1983 “Për transferimin e personave të dënuar” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, miratuar nga shteti shqiptar me Ligjin nr. 9169 datë 22.01.2004 lidhur me procedurën e ekzekutimit të vendimeve penale;
- nenet 24, 25 të Ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” lidhur me ekzekutimin vullnetar të vendimit apo forcërisht me anë të arrestimit;
- nenet 6 të KEDNJ dhe 42 të Kushtetutës në lidhje me parimin themelor kushtetues për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e krijuar me ligj, kompetente, e pavarur dhe e paanshme, etj.²⁶;
- nenin 122 të Kushtetutës në lidhje me epërsinë mbi të drejtën e brendshme të marrëveshjes së ratifikuar me ligj²⁷;

²² Pothuajse në të gjitha vendimet gjyqësore penale të analizuar/cituara burim vlerësimi.

²³ Vendimi nr. 139 datë 28.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

²⁴ Vendimi nr. 302 datë 26.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

²⁵ Vendimi nr. 50 (631) datë 03.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

²⁶ Vendimi nr. 04 (32) datë 15.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

²⁷ Vendimi nr. 50 (631) datë 03.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret, përveç çështjes penale (kërkesës penale), me objekt parashkrimi i ekzekutimit dhe shuarjes së dënimit, kur gjyqtarja ka evidentuar, se nuk është në rastin e zbatimit të Vendimit Unifikues nr.7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka interpretuar nenin 68 dhe 69 të Kodit Penal, por se gjen zbatim Marrëveshja shtesë e Konventës Europiane “Për transferimin e personave të dënuar”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italiës, e miratuar me ligjin nr.9169, datë 22.01.2004”, duke vlerësuar se në interpretim të nenit 122 të Kushtetutës kjo konventë ka epërsi mbi të drejtën e brendshme dhe është e ratifikuar me ligj dhe është e vetzbatueshme në kushtet kur nuk ka nevojë që për zbatimin e saj të nxirren akte të tjera ligjore e nënligjore²⁸.

KONKLuzioni

Në tërësi, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.B. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

²⁸ Vendimi nr. 50 (64-2015-631), datë 03.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 1.a.a “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast, me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtares, është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretim të tyre në mënyrë abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Interpretimi i dispozitave materiale/procedurale bëhet nga ana e gjyqtares, sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

(i) *Në vendimet gjyqësore civile:* Në të gjitha vendimet e analizuara, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj, por duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, duke i rënditur në çdo rast, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara e të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja :

- a) Interpreton në mënyrë literale dhe sistematike nenin 716 të K.Civil lidhur me përgjegjësitë e shitësit në rast mospërmbushje detyrimi, duke vijuar me nenin 772 të K.Civil për të konkluduar se në rastin konkret ndodhet para një marrëdhënie detyrimi, e lindur nga kontrata e furnizimit me sende në rastin konkret në trajtë energjie elektrike. Më tej gjyqtarja vijon dhe interpreton nenet 608, 609, 640 të K.Civil, në lidhje me detyrimin që lind nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor për një organ të administratës publike, përcaktimin e dëmit pasuror dhe kur pala mund të detyrohet për një dëm, etj.²⁹;

²⁹ Vendimi nr. 712 (1708) datë 11.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

- b) Interpreton dispozitat materiale të Kodit të Familjes, duke u ndalur në mënyrë të veçantë te nenet 132, 133, 134, 146/1 të K.Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve, si dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj³⁰. Gjithashtu, gjyqtarja referon dhe arsyeton në lidhje me përgjegjësinë prindërore pas zgjidhjes së martesës, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, nenet 3, 5, 215 të K.Familjes, si dhe mbi detyrimin e prindit që nuk i është lënë fëmija për kontribut bazuar në nenet 158, 161 të K.Familjes.

(ii) *Në vendimet gjyqësore penale* : Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen, në aspektin e provueshmërisë së faktit penal, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të Kodit Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj, si dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, veçanërisht në çështjet penale të themelit, ku ky interpretim është i domosdoshëm. Interpreton dispozitat materiale, në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht, konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të Kodit Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm, në lidhje me elementët dallues të veprës penale përkatëse, që i atribuohet të pandehurit dhe në vijim duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara e të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqendruar më tepër në anën objektive të saj, interpretim që bëhet edhe në raport me faktet e çështjes³¹.

Në të gjitha vendimet gjyqësore penale analizohen të katër elementët e figurës së veprës penale, në çështjet e themelit. Në këto të fundit, gjyqtarja përqendrohet më tepër në elementë të anës objektive të veprave penale, me qëllim cilësimin e saktë juridik të faktit penal. Konkretisht konstatohet se gjyqtarja :

- a) Interpreton në mënyrë literale dhe sistematike dispozitat materiale, nenet 259, 248, 245 të K.Penal me dispozita të pjesës së përgjithshme të po këtij kodi, që sanksionojnë moshën për përgjegjësi penale dhe fajin si elementë të domosdoshëm për të qenë përpara figurës së veprës penale. Gjykata, ndalet dhe në analizimin e faktit se në rastin konkret nuk ndodhet në kushtet e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, sipas nenit 59 të K.Penal, në raport me rrethanat e faktit³²;
- b) Interpreton dispozitën materiale të nenit 78/1 të K.Penal, në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Gjykata, ndalet dhe në analizimin e faktit se në rastin konkret nuk ndodhet në kushtet e nenit 82 të K.Penal sikurse ka pretenduar mbrojtja që vepra penale është kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike. Po këtu, gjyqtarja me qëllim analizimin e anës objektive të veprës penale “*Mbajtja pa leje e armëve luftarake*” interpreton në mënyrë të veçantë, duke vlerësuar dhe dhënë përkufizimin e armës së zjarrit sipas Ligjit nr. 7566 datë 25.05.1992 “*Për armët*”³³;

³⁰ Vendimet nr. 352 datë 06.05.2016; nr. 113 datë 21.02.2014; nr. 649 datë 22.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³¹ Në të gjitha vendimet gjyqësore penale burim vlerësimi

³² Vendimi nr. 220 (1066) datë 28.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³³ Vendimi nr. 139 (671) datë 28.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

- c) Interpreton dispozitën materiale të nenit 290 të K.Penal, në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri duke analizuar natyrën blankete të dispozitës (e bardhë) e cila për të përcaktuar se çfarë rregulli është shkelur për të pasur përgjegjësi penale personi, e çon në referimin e dispozitave ligjore të Kodit Rrugor. Konkretisht, gjyqtarja ndalet në analizimin e neneve 139, 140, 189 të këtij kodi³⁴;
- d) Interpreton në mënyrë literale dhe sistematike dispozitën materiale të nenit 291 të K.Penal, në funksion të cilësimit juridik të veprës penale, për të cilën akuzohet i pandehuri³⁵;
- e) Interpreton në mënyrë literale dhe sistematike dispozitën materiale (*nenin 134/2 të K.Penal*) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale, për të cilën akuzohet i pandehuri³⁶;
- f) Interpreton dispozitat materiale, nenet 84, 278, 283/1 të K.Penal me dispozita të pjesës së përgjithshme të po këtij kodi, që sanksionojnë moshën për përgjegjësi penale dhe fajin si elementë të domosdoshëm për të qenë përpara figurës së veprës penale. Gjykata, ndalet dhe në analizimin e faktit se në rastin konkret nuk ndodhet para veprës penale të parashikuar nga neni 278/4 siç është formuluar akuza nga prokurori, por para veprës penale të parashikuar nga neni 278/5, pasi ka bërë dhe interpretimin e përkufizimit të armës së zjarrit, në referim të nenit 2 të Ligjit 99/2013 “Për armët” në lidhje me vendin ku ajo është mbajtur dhe sekuestruar. Gjithashtu, gjyqtarja në lidhje me përgjegjësinë penale të pandehurit, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, referohet dhe arsyeton mbi vendimin unifikues nr. 1 datë 27.03.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke rrëzuar pretendimin e mbrojtësit për pushimin e akuzës sepse doza e sekuestruar ishte e tillë që përdorej për përdorim vetjak³⁷;
- g) Interpreton nenin 137/1 të K.Penal, në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal, atribuar të pandehurit, mbështetur në rrethanat e faktit dhe provat përkatëse³⁸;
- h) Në të gjitha vendimet penale interpretimin e normave relevante gjykata nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar të katër elementët e veprave penale, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Referuar provave të lejuara dhe të marra në shqyrtim dhe të analizuar në tërësinë e tyre, gjykata konkludon në cilësimin juridik të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të autorëve, për veprën penale që atyre u atribuohet.

Krahas interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme, në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse, për të cilat akuzohen të pandehurit, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi edhe *interpretimit të dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal* në lidhje me:

- a) Rrethanat cilësuese të tilla si kryerja e veprës penale me dhunë ose më shumë se një herë.
- b) Fajin si element të anës subjektive të veprës penale.

³⁴ Vendimi nr. 101 datë 02.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³⁵ Vendimi nr. 225 (1961) datë 21.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³⁶ Vendim nr. 04 (32) datë 15.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³⁷ Vendimi nr. 391 (2360) datë 16.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³⁸ Vendimi nr. 382 (1973) datë 16.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

- c) Përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*), qëllimin e dënimit penal, si dhe aplikimin e rrethanave që ndikojnë në individualizimin e dënimit për të pandehurin. Gjyqtarja, ndalet dhe në analizimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duke interpretuar nenin 59 të K.Penal, si formë alternative të vuajtjes së dënimit, duke analizuar elementët thelbësorë të aplikimit të tij, si dhe duke e aplikuar në raport me rrethanat e rastit konkret, por edhe në rastin e mosaplikimit të kësaj forme (sipas kërkesës së të pandehurit) dënimi alternativ, ndalet në arsyetim.
- d) Aplikimin e nenit 55 të K.Penal, për bashkim e disa dënimeve duke përdorur sistemin e dënimit më të rëndë të shtuar.
- e) Bazuar në natyrën dhe llojin e veprës penale, në pasojën e ardhur nga kryerja e saj, aplikon dhe analizon mbi dhënien e dënimit plotësues sipas neneve 30, 37, 44 të K.Penal.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- a) Në vendimin penal me objekt “Vleftësim arrestimi dhe caktim mase sigurimi”, gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në lidhje me konceptin e flagrancës dhe vlerësimin që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit³⁹;
- b) Në vendimin penal me objekt “Deklarimin e parashkrimit të ekzekutimit dhe shuarjes së dënimit”, gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në lidhje me kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale (neni 470 i K.Pr.Penale). gjithashtu referon dhe interpreton nenet 2, 4 të Marrëveshjes shtesë të Konventës Europiane të datës 21 mars 1983 “Për transferimin e personave të dënuar” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, miratuar nga shteti shqiptar me Ligjin nr. 9169 datë 22.01.2004 lidhur me procedurën e ekzekutimit të vendimeve penale, nenet 24, 25 të Ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” lidhur me ekzekutimin vullnetar të vendimit apo forcërisht me anë të arrestimit, nenin 122 të Kushtetutës në lidhje me epërsinë mbi të drejtën e brendshme të marrëveshjes së ratifikuar me ligj⁴⁰;
- c) Në çështjet penale të themelit gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale, në mbështetje të argumentimit të saj, në lidhje me vlerësimin për kërkesën për procedim me gjykim të shkurtuar (*neni 403, 404 i K.Pr.Penale*).

³⁹ Vendim nr. 302 (2450) datë 26.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁴⁰ Vendimi nr. 50 datë 03.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Në çështjet civile: Në funksion të evidentimit të marrëdhënies juridike, të krijuar mes palëve ndërgjyqëse e për pasojë konstatimin e juridiksionit dhe kompetencës lëndore në shqyrtimin e çështjes, gjyqtarja interpreton nenet 36/1, 32/a, 41, 43, 59 të K.Pr.Civile.

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.***

Në vendimet e analizuara rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- a) Në vendimin gjyqësor civil nr. 649, datë 22.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, gjyqtarja referon dhe arsyeton në lidhje me përgjegjësinë prindërore pas zgjidhjes së martesës, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, nenet 3, 5, 215 të K.Familjes, si dhe mbi detyrimin e prindit që nuk i është lënë fëmija për kontribut bazuar në nenet 158, 161 të K.Familjes, si dhe nenin 3 të Konventës së OKB-së “Mbi të drejtat e fëmijëve”⁴¹;
- b) Në vendimin gjyqësor penal nr. 391 (2360), datë 16.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, gjyqtarja referon dhe arsyeton mbi vendimin unifikues nr. 1 datë 27.03.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, duke rrëzuar pretendimin e mbrojtësit për pushimin e akuzës sepse doza e sekuestruar ishte e tillë që përdorej për përdorim vetjak;
- c) Në vendimin gjyqësor penal nr. 50 (631), datë 03.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në analizë të faktit të ndërprerjes së parashkrimit të ekzekutimit të vendimit penal, në rastet kur ka filluar ekzekutimi dhe është ndërprerë vuajtja e dënimit, gjykata referohet në qëndrimin unifikues të mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 7, datë 11.10.2022.

- ***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***

Nga tërësia e vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtarja gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsyetimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- a) *Parimin e veprimit të ligjit civil në kohë* në funksion të evidentimit të ligjit të zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprimit juridik.
- b) *Parimin “Juria novit curia”*, sipas të cilit gjykata njeh ligjin, në funksion të evidentimit se gjykata ka detyrimin për të bërë cilësim të saktë të fakteve, pa u lidhur me përcaktimin që bëjnë palët.
- c) *Parimin “Judicus est judicare secundum allegata et probata”*, sipas së cilit vendimmarrja e një gjyqtari duhet të bëhet në bazë të bindjes së brendshme të

⁴¹ Vendimi nr. 649 datë 22.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

- bazuar në prova.
- d) *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit, në të cilat gjyqtarja analizon domosdoshmërinë e ekzistencës dhe provueshmërisë së të katër elementëve të figurës së veprës penale, si kusht për ekzistencën e saj dhe për pasojë, për përgjegjësinë penale të të pandehurit, për faktin penal që i atribuohet.
 - e) Parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, *si parimi i barazisë para ligjit, parimi i drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe parimi i humanizmit*. Në kuadër të zbatimit të këtyre parimeve, gjyqtarja në të gjitha vendimet penale të themelit, përcakton dhe individualizon dënimin për të pandehurin duke iu referuar kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 47 e vijues të Kodit Penal dhe duke analizuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të të pandehurit.
 - f) *Parimet themelore të procesit gjyqësor civil të parashikuar në nenet 10, 11, 12, 14, 16 etj. (procesi i rregullt ligjor nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile, barra e provës, kontradiktoriteti, etj.)*, mbi bazën e të cilave gjykata disponon për bazueshmërinë ose jo të padisë.
 - g) *Parimin e interesit më të lartë të fëmijës*, në përcaktimin e përgjegjësisë prindërore, duke cituar nenet 3, 6 të Kodit të Familjes si dhe nenin 3 të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsytim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B. Arsytimi ligjor.

1.B.A. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsytimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin

e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formular. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar⁴².

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...}, ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme, por në ndonjë rast, përfshirja e tekstit të plotë të deklarimeve të dëshmitarëve i jep vendimit volum të panevojshëm. Në arsyetim respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe i ka përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit civil (shihni dosjet 1 e 2) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shihni dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 3, 4 e 5).*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton se në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, gjithashtu dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit.

Gjuha teknike, përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdoruara nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e

⁴² Vendimi i GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine, por gjithmonë kuptimi i tyre jepet në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimin e fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarës për përzgjedhjen e gjuhës së përdorur, me qëllim shmangien e fjalëve apo shprehjeve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke pasur në vëmendje respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe disa herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës, gjithashtu dhe paragrafët e arsytimit të vendimit. Vendimi është i organizuar me paragrafë, në disa raste të numërtuara, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike, hyrëse, të cilat e bëjnë shumë të lehtë leximin e organizuar. Karakteristike e gjyqtarës është përmbyllja e arsytimit në secilin paragraf apo pjesë të vendimit më një ose disa fjali përmbyllëse, që vijjnë si rrjedhë logjike e mendimit të shprehur dhe përbëjnë konkluzionin e arritur mbi elementin konkret të marrë në analizë.

Në vendimet përfundimtare burim vlerësimi gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë në çdo rast elementët proceduralë si kompetenca, juridiksioni, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet prospektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këto elementë kanë qenë të diskutueshme nga palët apo rrethanat e çështjes. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja në mënyrë të specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, konstatohet se në të gjitha vendimeve të analizuara, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, i jep qartësi elementëve procedurale të gjykimit ose vendimit dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.B. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristët/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : “*Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit civil (shihni dosjet 1 e 2) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shihni dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 3, 4 e 5). Arsytimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e

arritura, të cilat vijjnë gjithnjë në përmbyllje procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretaria gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (padi së ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur ose në disa raste në mënyrë më të gjatë.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të listuar formalisht me tituj, duke orientuar qartë lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimi ndjek kryesisht këtë renditje:

(i) procedura, edhe pse jo e evidentuar me këtë titull. Në këtë pjesë gjyqtarja ndalet kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes, si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit gjyqësor si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për shtim të objektit të padi së⁴³, ezaurimin e procedurës së pajtimit⁴⁴, shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar⁴⁵, etj.

(ii) faktet e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave, të cilat përshkruhen dhe analizohen menjëherë pas përshkrimit të rrethanave procedurale.

(iii) analizën ose vlerësimin ligjor të gjykatës lidhur me çështjen. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale, ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Në pjesën tjetër të vendimeve, penale ose civile, gjyqtarja organizon pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit duke ndjekur kryesisht metodën e dhënies së konkluzionit të saj mbi bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt padie apo kërkesës penale, për të vijuar më pas me shtjellimin dhe renditjen e argumenteve në mbështetje të këtij konkluzioni. Ndërkohë, në çështjet penale të themelit, analiza ligjore organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zberthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përjasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe

⁴³ Vendimi nr. 712 (1708) datë 11.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁴⁴ Vendimet nr. 352 datë 06.05.2016; nr. 11 datë 21.02.2014 dhe nr. 649 datë 22.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁴⁵ Në të gjitha vendimet gjyqësore penale të analizuara

fajësinë e të pandehurit, dhe më tej me analizën në një pjesë më vete, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, lidhur më kërkesën, akuzën apo padinë, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarisë gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë), në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (deklarimin fajtor), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike (për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit apo për rrëzimin e kërkesës me objekt ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal), dënimin dhe masën e dënimit, llogaritjen e dënimit, mënyrën e ekzekutimit të tij, disponimi mbi provat materiale, masat e sigurimit, si dhe shpenzimet gjyqësore, të cilat gjejnë pasqyrim në të gjitha vendimet. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj, kur fillon të llogaritet ky afat për secilën palë ndërgjyqëse.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 259 dhe 245 të K.Pr.Penale, në vendimin për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme si në aspektin vizual ashtu dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

1.B.C. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballë gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : *“Subjekti i rivlerësimit {...}, ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor.Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve, i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por rrallë rezulton e plotësuar me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuuese e Gjykatës së Lartë. Një konstatim i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, pa përdorur fjali të përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara, respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar në asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cënuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e afati i ankimit për palët. Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore të tyre”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm, në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal. Evidentohet kujdesi i veçantë gjyqtarës në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi si pasojë e një analize të detajuar të të ligjit të zbatueshëm në raport me rrethanat konkret të çështjes, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat gjithashtu janë evidentuar në një pjesë të vendimit, të identifikuar qartë.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për secilin kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale.

Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimit logjik, për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet, ecurinë procedurale të gjykimit, kushteve dhe kriterëve ligjore të individualizimit të dënimit, kushteve dhe kriterëve ligjore të aplikimit të masave të sigurimit personal, aplikimit të alternativave të dënimit me burgim dhe qëllimit të aplikimit të tyre në raport me arritjen e qëllimit të dënimit penal apo zbatimin e parimit të caktimit të dënimit në mënyrë të drejtë dhe proporcionale.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.) apo janë pjesë e analizës ligjore, duke u identifikuar në mënyrë të veçantë në fund të pjesës arsyetuese. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçantë të arsyetimit (por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret), pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë, merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.A. Respektimi i afateve ligjore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë gjithnjë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 ditë, (shih dosjen 5), deri në 7 muaj e 2 ditë (shih dosjen 4). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimin ka qenë 1 muaj e 13 ditë (shih dosjen 3) 3 muaj (shih dosjen 2) dhe 3 muaj e 18 ditë (shih dosjen 1). Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezultoi se kohëzgjatja e këtyre gjykimeve në një rast ka qenë brenda afateve standard dhe në intervalin kohor 1 muaj e 6

ditë (shih dokumentin 3), ndërsa në dy rastet e tjera jashtë afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 7 muaj (shih dokumentin 2) dhe 1 vit e 1 muaj e 22 ditë (shih dokumentin 1).”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja dhe vendimeve të administruara për shkak referimi nga ish Inspektorati i KLD-së për t'u mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu, edhe për çështjet civile të themelit, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor në Kodin e Procedurës Civile për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 (dy) vendimeve të administruara për shkak të referimit nga ish Inspektorati i KLD-së, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor, brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes.

Konkretisht:

- Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*vleftësim arrestimi në flagrancë dhe caktim mase sigurimi*), ku parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale.⁴⁶ Referuar vendimit gjyqësor penal nr. 302, datë 26.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit është regjistruar në gjykatë më datë 25.11.2015 dhe ka përfunduar më datë 26.11.2015, pra brenda afatit ligjor prej 48 orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe se edhe kjo çështje rezulton që të jetë përfunduar brenda afatit ligjor për përfundimin e saj, rezulton se raporti i shprehur në përqindje është 0% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në

⁴⁶ Neni 259 i K.Pr.Penale parashikon se “...5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë”.

çështjen e analizuar, për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton në nivelin 0 %.

2.A.B. Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë gjithnjë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 ditë, (shih dosjen 5), deri në 7 muaj e 2 ditë (shih dosjen 4). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 13 ditë (shih dosjen 3) 3 muaj (shih dosjen 2) dhe 3 muaj e 18 ditë (shih dosjen 1). Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se kohëzgjatja e këtyre gjykimeve në një rast ka qenë brenda afateve standard dhe në intervalin kohor 1 muaj e 6 ditë (shih dokumentin 3), ndërsa në dy rastet e tjera jashtë afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 7 muaj (shih dokumentin 2) dhe 1 vit e 1 muaj e 22 ditë (shih dokumentin 1).”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10⁴⁷ (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 (dy) vendime të administruara për shkak referimi nga ish Inspektorati i KLD-së, për t’u mbajtur parasysht për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.

⁴⁷ Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht vendimi gjyqësor kërkesë penale me nr. 302, datë 26.11.2015.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara, gjykimi ka përfunduar përgjithësisht brenda standardeve minimale kohore, nga ku, referuar Vendimit nr. 261/2 të ish KLD-së, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

Çështje penale të kategorisë krime:

- Dosja 3 - (*është caktuar me short në datën 02.12.2013 dhe ka përfunduar në datën 15.01.2014*) Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 13 ditë, **brenda afatit** 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve ;
- Dosja 4 - (*është caktuar me short në datën 29.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 02.03.2015*) Gjykimi ka zgjatur 7 muaj e 2 ditë, **brenda afatit** 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve
- Dosja 7 - (*është caktuar me short në datën 19.11.2013 dhe ka përfunduar në datën 21.11.2013*) Gjykimi ka zgjatur 2 ditë, **brenda afatit** 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve ;
- Dosja 9 - (*është caktuar me short në datën 11.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 16.12.2014*) Gjykimi ka zgjatur 5 ditë, **brenda afatit** 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve ;
- Dosja 11 - (*është caktuar me short në datën 21.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 16.11.2015*) Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 25 ditë, **brenda afatit** 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve ;
- Vendimi 1 - (*është regjistruar me short në datën 06.03.2013 dhe ka përfunduar në datën 28.04.2014*) Gjykimi ka zgjatur 1 vit 1 muaj 22 ditë, **jashtë afatit** 12 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime të cilat dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burg apo me burgim të përjetshëm), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve. Megjithatë po të zbresim nga ky afat, muajin gusht gjatë secilët gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen vjetore, rezulton se çështja është gjykuar për një afat prej 12 muaj e 22 ditë, përsëri jashtë standardin minimal kohor, duke e tejaluar këtë afat me 22 ditë.
- Vendimi 3 - (*është regjistruar me short në datën 22.04.2015 dhe ka përfunduar në datën 28.05.2015*) Gjykimi ka zgjatur 1 muaj 6 ditë, **brenda afatit** 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve ;
- Çështja penale⁴⁸ që i përket vendimit nr. 169 datë 02.10.2013, (*është regjistruar me short në datën 30.11.2012 dhe ka përfunduar në datën 02.10.2013*) Gjykimi ka zgjatur 9 muaj 3 ditë, **jashtë afatit** 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime), të përcaktuar në pikën 5 gërma “a” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, duke e tejkuluar këtë afat me 3 ditë, tejkulim i

⁴⁸ Referuar nga Inspektorati i KLD-së për t'u mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional

cili vlerësohet i papërfillshëm. Megjithatë në rast se nga ky afat do të zbresim periudhën gjatë secilës gjyqtarët kryerjen lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar për një periudhë prej 8 muaj e 3 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale

Çështje civile të përgjithshme :

- Çështja civile⁴⁹ që i përket vendimit nr. 06 datë 08.01.2016 (*është caktuar me short në datën 18.10.2013 dhe ka përfunduar në datën 08.01.2016*) Gjykimi ka zgjatur 1 vit 2 muaj e 10 ditë, pra **jashtë afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- Dosja 3 - (*është caktuar me short në datën 04.11.2013 dhe ka përfunduar në datën 05.02.2014*) Gjykimi ka zgjatur 3 muaj, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- Dosja 8 - (*është caktuar me short në datën 24.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 11.11.2014*) Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 17 ditë, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5 gërma “e” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;

Çështje familjare:

- Dosja 1 - (*është caktuar me short në datën 18.01.2016 dhe ka përfunduar në datën 06.05.2016*) Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 18 ditë, **brenda afatit** 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet familjare;
- Dosja 6 - (*është caktuar me short në datën 03.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 21.02.2014*) Gjykimi ka zgjatur 19 ditë, **brenda afatit** 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet familjare, të përcaktuar në pikën 5 gërma “d” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- Dosja 10 - (*është caktuar me short në datën 09.05.2016 dhe ka përfunduar në datën 22.09.2016*) Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 13 ditë, pra **jashtë afatit** 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet familjare, të përcaktuar në pikën 5 gërma “d” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve. Megjithatë, po të zbresim nga ky afat, muajin gusht, gjatë secilit gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen e zakonshme, rezulton se çështja ka zgjatur 3 muaj e 13 ditë, pra **brenda standardit** minimal kohor prej 4 muajsh të përcaktuar në vendimin e ish Kld-së nr.261/1, viti 2010.

Kërkesa penale:

- Vendimi 2 - (*është regjistruar në datën 04.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 03.04.2015*) Çështja ka përfunduar për 7 muaj, **jashtë afatit** 2 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet çështjeve të karakterit administrativo-penal, të përcaktuar në pikën 5 gërma “j” të Aneksi 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 15 (pesëmbëdhjetë) çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së, pasi 3 (tre) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra në total 20 % të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

⁴⁹ Referuar nga Inspektorati i KLD-së për t'u mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për 80 % të çështjeve të analizuara. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 20 % përkon me nivelin e vlerësimit 4 (katër) pikë (Mbi 10-20%- 4).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtarja ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Në lidhje me kompleksitetin e çështjeve, i përcaktuar në Metodologji si një nga komponentët, që mund të çojë në një pikëzim më të lartë, se ai që rezulton nga analiza matematikore, rezulton si më poshtë:

- Çështja që i përket vendimit gjyqësor penal nr. 139, datë 28.04.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes penale, që i përket palës kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt gjykimin e të pandehurit Sh.Ll., i akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Vrasja me paramendum”* parashikuar nga neni 78/1 i K.Penal dhe *“Mbajtja pa leje e armëve luftarake”* parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 06.03.2013 dhe datë përfundimi 28.04.2014, duke përfunduar brenda një afati prej 1 vit, 1 muaj e 22 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 12 (dymbëdhjetë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së. Po të zbrisim nga ky afat muajin gusht gjatë të cilit gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen vjetore, rezulton se çështja është gjykuar për një periudhë prej 12 muaj e 22 ditë, duke e tejkaluar këtë afat me 22 ditë. Duke qenë se është vendim gjyqësor i zgjedhur nga gjyqtarja nuk është administruar dosja gjyqësore, nga ku mund të rezultonin të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes. Megjithatë referuar përmbajtjes së vendimit, rezulton se gjykimi ka vazhduar me procedurë të zakonshme dhe gjatë këtij gjykimi, prokuroria ka kërkuar ndryshimin e akuzës dhe si pasojë, gjykata në respektim të të drejtave ligjore të pandehurit i ka dhënë mundësinë për të mbajtur qëndrim bashkë me mbrojtjen e tij (referuar neneve 372, 376 të K.Pr.Penale). Rezulton se gjatë gjykimin janë administruar një sërë provash shkresore si dhe janë marrë prova me dëshmitar, të kërkuar nga përfaqësuesi i organit të akuzës dhe nga mbrojtja. Nga deklaratimet e marra në gjykim, sa ka rezultuar, gjykata ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për sekuestrimin e provave materiale duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të duhura nga policia gjyqësore, veprime të cilat kanë kërkuar kohën e nevojshme për t'u kryer. Gjithashtu, në gjykim është vendosur kryerja e një ekspertimi me grup ekspertësh nga Intituti i Mjekësisë Ligjore lidhur me përgjegjshmërinë e një prej dëshmitarëve, zotësinë e tij për të dëshmuar. Ky veprim procedural ka kërkuar kohën e nevojshme për t'u kryer duke u ndjekur hapat procedural caktimi dhe njoftimi i ekspertëve në gjykatë, caktimi i detyrave përkatëse pas betimit, marrja kohën e duhur për kryerjen e aktit, depozitimi i aktit dhe dhënia kohë palëve për të mbajtur qëndrim me të etj. Rezulton se pas depozitimit të aktit, ekspertët edhe janë pyetur para gjykatës në lidhje me të. Referuar ecurisë procedurale, shkallës së kompleksitetit të çështjes, llojit të veprës penale për të cilën është dënuar i pandehuri, faktin se gjykimi ka vijuar me procedurën e gjykimit të zakonshëm ku janë marrë një sërë provash, si dhe fakti që tejkalimi i çështjes nga standardi minimal kohor është vetëm 22 ditë, duke përjashtuar periudhën e lejes vjetore të muajit gusht (1 muaj), vlerësohet se gjyqtarja ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e çështjes brenda standardit minimal kohor dhe tejkalimi i këtij afati ka ndodhur për shkaqe procedurale që nuk lidhen me aftësinë e gjyqtarës për të menaxhuar gjykimin.

- Çështja që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 06 datë 08.01.2016⁵⁰ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile me objekt “Pushimin e cënimit të së drejtës së përdorimit të lirë të sendit, lirimit e banesës dhe shpërblimit e dëmit të shkaktuar deri në momentin e lirimt të banesës”. Referuar të dhënave të raportit analizues të ankesës, të ish KLD-së rezulton se çështja është regjistruar në datë 18.10.2014 (pranë gjyqtarës subjekt vlerësimit) dhe ka përfunduar 08.01.2016, duke përfunduar brenda një afati prej 1 vit 2 muaj e 10 ditë, pra **jashtë afatit** 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile. Referuar të dhënave të analizuara në materialin e analizuës të ankesës, rezulton se çështja i është shortuar gjyqtarës {...} (pasi më parë ka qenë pranë një gjyqtareje tjetër e cila është transferuar nga kjo gjykatë) me datë 18.10.2014 dhe ka përfunduar me datë 08.01.2016, duke zgjatur 1 vit 2 muaj 20 ditë. Për përfundimin e kësaj çështje janë zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 24 seanca gjyqësore, nga të cilat rezulton se : *“4 seanca janë shtyrë për marrjen e një fashikulli gjyqësor pranë gjykatës; 8 seanca janë shtyrë për të njoftuar ekspertin, në vijim grupin e ekspertëve ku është kërkuar dhe akt ekspertimi shtesë; 2 seanca janë shtyrë për shkak se pala e paditur ka kërkuar të përfaqësohet me avokat; 1 seancë është shtyrë për t’u diskutuar akti i ekspertimit; 1 seancë është shtyrë për t’u njoftuar grupi i ekspertëve, pasi është pranuar kërkesa e palës paditëse për ekspertim me grup ekspertësh; seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe të detyrueshme procedurale, diskutimi i aktit të ekspertimit, konkluzionet përfundimtare, dhënia e vendimit përfundimtar. Referuar raportit të verifikimit të ankesës, rezulton se është arritur në përfundimin se ; shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë për arsye objektive, dhe se gjyqtarja në asnjë rast nuk është bërë shkak për shtyrjen e seancës. Çështja ka qenë relativisht e ndërlikuar, pasi pretendohet për pavlefshmërinë e procedurës së privatizimit të një objekti shtetëror, ku duhej të administrohej kjo procedurë nga institucionet e tjera, procedurë e cila ka detyruar gjykatën të shtyjë seancën disa herë. Edhe kryerja e ekspertimit, më tej me grup ekspertësh, dorëheqja e ekspertëve, përgatitja e aktit, kanë marrë një periudhë relativisht të gjatë kohore, duhet përjashtuar periudha e lejes vjetore të muajit gusht (1 muaj) gjatë periudhës së gjykimt si dhe fakti se jatë kësaj periudhe janë të përfshira disa festa zyrtare ndër to dhe ato të fundvitit, apo ditët e mbartjeve të dosjeve në fillim të çdo viti referuar praktikave të gjykatave. »*

- Çështja që i përket vendimit gjyqësor penal nr. 50, datë 03.04.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes penale, që i përket palës kërkuese C.E, me objekt *“Deklarimin e parashkimit të ekzekutimit dhe shuarjes së dënimit që ai përmban, si dhe urdhërimi i mosekzekutimit për vendimin penal nr. 85 datë 22.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ndryshuar”*. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 04.09.2014 dhe datë përfundimi 03.04.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 7 (shtatë) muajsh, pra jashtë standardit minimal kohor prej 2 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së. Duke qenë se ky është një vendim i zgjedhur, nuk është administruar dosja nga e cila mund të rezultonin të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes.

Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve, sipas pikës 3 shkronja “g”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështjes civile me palë kundërshtare.

Ndërsa në pikën 3, shkronja “k” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se: *“Kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese minimale respektivisht në masën e 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate”*.

⁵⁰ Referuar nga Inspektorati i KLD-së për t’u mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional

Referuar të dhënave statistikore, rezultoi se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (08.10.2013-08.10.2016), 1154 çështje, nga të cilat 608 çështje me palë kundërshtare dhe 546 çështje pa palë kundërshtare (kërkesa penale dhe civile, duke e tejkaluar standardin sasior për çështjet me palë kundërshtare me vetëm 8 çështje.

Por gjatë periudhës së vlerësimit, për periudhën 08.10.2013 deri rreth fundit të muajit Korrik 2014 (datë 23.07.2014) gjyqtarja ka ushtruar edhe detyrën e kryetares së gjykatës, pra për një periudhë prej rreth 9 muaj e 15 ditë, çka nënkupton se gjatë kësaj periudhe duhet të kishtë një pjesmarrje në short jo më pak se 40 % të çështjeve (por nga të dhënat statistikore nuk duket se gjatë kësaj periudhe është vetpërfunduar nga shorti), apo të ketë gjykuar rreth 60 çështje me palë kundërshtare gjatë periudhës prej 9 muajsh dhe gjatë vitit të plotë rreth 100, duke e tejkaluar standardin sasior për këtë periudhë me 100 çështje me palë kundërshtare.

Gjithashtu, ka rezultuar se gjatë periudhës qershor – korrik 2015 gjyqtarja ka qenë me leje studimore, të miratuar nga ish KLD- dhe gjatë kësaj periudhe ajo nuk ka dhënë asnjë vendim gjyqësor, fakt që rezulton edhe nga të dhënat statistikore. Për pasojë gjatë këtij viti, gjyqtarja duhet të përfundonte në minimum jo më pak se 155 çështje me palë kundërshtare, pasur parasysh se nuk ka qenë efektivisht në punë për gjithë vitin e plotë, ndërsa ajo ka përfunduar 228 çështje me palë kundërshtare, duke e tejkaluar kështu standardin minimal me 74 çështje apo me 47 %.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit (3 nga 15 çështje të gjykuara) që rezulton 20 % ; (ii) ngarkesën e gjyqtares si relatores për periudhën e vlerësimit (në total për 3 vite pune ka gjykuar 1154 çështje, nga të cilat 608 janë çështje me palë kundërshtare); (iii) faktin se ajo e ka tejkaluar standardin sasior mesatare me shumë se 100 çështje për të gjithë periudhën 3 vjeçare, pra më pak se 50% të çështjeve me palë kundërshtare; (iv) shkaqet që kanë çuar në përfundimin e çështjeve jashtë afatit të standardit minimal kohor, të cilat kanë qenë gjithmonë për shkaqe procedurale, të diktuar nga procesi gjyqësor; (v) faktin se për periudhën 08.10.2013 deri në datën 23.07.2014 ajo ka ushtruar edhe detyrën e kryetares së gjykatës dhe për muajit qershor- korrik 2015 ka qenë me leje studimore; (vi) angazhimin e gjyqtares në trupa gjykues, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket të dhënave statistikore duke arritur në pikëzimin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 20 % të çështjeve jashtë standardit minimal ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares.

2.A.C. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 2.A.B “*Plotësimi i standardeve minimale kohor*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, dhe 2 (dy) vendime të administruara për shkak referimi nga ish Inspektorati i KLD-së për t’u mbajtur parasysht për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit⁵¹.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (nga 15 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 3 çështje familjare, 8 çështje penale themeli, 3 çështje civile dhe 1 kërkesë administrativo-penale), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 8 (tetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 133 ditë, ose 4 muaj e 13 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë rreth 210 ditë, ose 7 muaj, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtarë”, rezulton të jetë 86 ditë ose 2 muaj e 26 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 (katër) muaj për gjykimin e çështjeve familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë.

⁵¹ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale”, rezulton të jetë 7 muaj, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 2 (dy) muaj për gjykimin e çështjeve të karakterit administrativo-penal në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Referuar 15 çështjet e marra në analizë, duke qenë statistikat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet për tu analizuar lidhur me këtë tregues, rezulton se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve, pasi nga 4 (katër) kategori çështjesh, standardi minimal është tejkaluar vetëm për 2 prej tyre, që sipas Metodologjisë së Vlerësimit pikëzohet me 3 pikë.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.⁵²

Sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë rreth 210 ditë, ose 7 muaj, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë. Çështja që ka ndikuar në këtë mesatare, është çështja civile e referuar nga Inspektorati i KLD-së për t’u mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, e cila ka qenë komplekse. Në kohën mesatare për këtë kategori çështjes, ndikon ndjeshëm kohëzgjatja e çështjes që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 06 datë 08.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile me objekt “Pushimin e cënimit të së drejtës së përdorimit të lirë të sendit, lirimin e banesës dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar deri në momentin e lirit të banesës”, e referuar për efekt vlerësimi nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, e cila ka përfunduar për një afat prej 1 vit 2 muaj e 10 ditë. Kjo çështje i është shortuar gjyqtare në datë 18.10.2014 dhe ka përfunduar me datë 08.01.2016, duke zgjatur 1 vit 2 muaj 20 ditë. Për përfundimin e kësaj çështje janë zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 24 seanca gjyqësore, nga të cilat rezulton se : “4 seanca janë shtyrë për marrjen e një fashikulli gjyqësor pranë gjykatës; 8 seanca janë shtyrë për të njoftuar ekspertin, në vijim grupin e ekspertëve ku është kërkuar dhe akt ekspertimi shtesë; 2 seanca janë shtyrë për shkak se pala e paditur ka kërkuar të përfaqësohet me avokat; 1 seancë është shtyrë për t’u diskutuar akti i ekspertimit; 1 seancë është shtyrë për t’u njoftuar grupi i ekspertëve, pasi është pranuar kërkesa e palës paditëse për ekspertim me grup ekspertësh; seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe të detyrueshme procedurale, diskutimi i aktit të ekspertimit, konkluzionet përfundimtare, dhënia e vendimit përfundimtar. Referuar raportit të verifikimit të ankesës, rezulton se është arritur në përfundimin se ; shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë për arsye objektive, dhe se gjyqtarja në asnjë rast nuk është bërë shkak për shtyrjen e seancës dhe se çështja ka qenë relativisht e ndërlikuar, pasi pretendohet për pavlefshmërinë e procedurës së privatizimit të një objekti shtetëror, ku

⁵² Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

duhej të administrohej kjo procedurë nga institucionet e tjera, procedurë e cila ka detyruar gjykatën të shtyjë seancën disa herë. Edhe kryerja e ekspertimit, më tej me grup ekspertësh, dorëheqja e ekspertëve, përgatitja e aktit, kanë marrë një periudhë relativisht të gjatë kohore, duhet përjashtuar periudha e lejes vjetore të muajit gusht (1 muaj) gjatë periudhës së gjykimit si dhe fakti se gjatë kësaj periudhe janë të përfshira disa festa zyrtare ndër to dhe ato të fundvitit, apo ditët e mbartjeve të dosjeve në fillim të çdo viti referuar praktikave të gjykatave. » Megjithatë, po të zbresim nga kjo llogaritje, 2 muajt gusht gjatë secilës gjyqtarët kryejnë lejen e zakonshme, si dhe muajt qershor dhe korrik të vitit 2015 gjatë të cilëve gjyqtarja ka qenë me leje për arsye studimore të miratuara nga ish KLD, atëherë do të rezultojnë se çështja ka përfunduar për një periudhë prej 10 muaj e 20 ditë. Kështu nëse do të bëjmë një rillogaritje të kohës mesatare për 3 çështje çështjet civile, pasi për të kemi zbritur muajt gusht gjatë secilës gjyqtarët kryejnë lejen e zakonshme, rezulton se kjo kohë është 164 ditë, pra brenda afatit të standardi minimal kohor prej 6 muajve.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, sa i përket kategorisë “Kërkesa penale”, është vetëm një çështje e cila ka zgjatur për rreth 7 muaj, nga dy që parashikohet për gjykimin e çështjeve të karakterit administrativo-penal në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe për të cilën nuk ka të dhëna për kohën e shortimit si dhe shkaqet që kanë ndikuar në zgjatjen e këtij gjykimi, duke qenë se është vendimi i zgjedhur nga gjyqtarja.

KONKLUZIONI

Referuar si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve, e cila referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 3 pikë. Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (*treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore”*), konkretisht duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjeve dhe të zgjatjes së një gjykimi civil themeli, të cilat kanë qenë vetëm për shkaqe procedurale, dhe në asnjë rast për shkak të gjyqtarës, komplekistetit të çështjes, ku është dashur marrja edhe e provës me ekspert (grup ekspertësh si dhe përjashtimi i ekspertëve, faktin se është vetëm një çështje, e cila ka tejkalluar afatin prej dy muaj të standardit minimal kohor, në raport me 12 çështje të tjera penale themeli dhe civile themeli të cilat kanë përfunduar brenda standardeve minimale, e cila në fakt është një kërkesë penale për parashkrimin e ekzekutimit dhe shuarjen e dënimit të një një vendimi gjyqësor shqiptar, të njohur nga shteti italian, për të cilën nuk ka asnjë të dhënë lidhur me shkaqet e shtyrjes së seance, vlerësohet që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë sa ai që i përket të dhënave statistikore, duke u rritur me një nivel vlerësimi, që i përket pikëzimit me 4 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje duhet të konsiderohet më e shkurtër se afati për shumicën e kategorive, pwr pasojw në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 4 pikë.*

2.A.Ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, njëkohësisht në dhomën civile dhe penale. Ajo ka deklaruar se gjatë viteve 2013 deri 2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 1430 çështje dhe ka përfunduar si kryesuese gjithsej 1333 çështje, duke mbartur vitin e fundit 68 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 93,2 %*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga ish- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} Karanzha ka përfunduar 1154 çështje nga të cilat; 459 çështje penale ku përfshihen edhe kërkesat dhe masat e sigurimit personal, 493 civile të përgjithshme ku përfshihen civile themeli, urdhëra ekzekutimi dhe kërkesa të tjera civile dhe 202 çështje familjare.

Referuar këtyre të dhënave statistikore, rezultoi se gjyqtarja {...} për gjithë periudhën e vlerësimit 08.10.2013- 08.10.2016, ka shqyrtuar këto çështje, të ndarë për çdo vit kalendarik:

- **Për vitin 2013** (08.10.2013- 31.12.2013), ka përfunduar 55 çështje, nga të cilat ; 7 civile themeli, 12 çështje familjare, 6 kërkesa civile, 2 kërkesa penale, 10 masa sigurimi personal, 9 penale themeli dhe 9 urdhëra ekzekutimi ;
- **Për vitin 2014** (01.01.2014- 31.12.2014), ka përfunduar 294 çështje, nga të cilat ; 40 civile themeli, 50 çështje familjare, 13 kërkesa civile, 5 kërkesa penale, 54 masa sigurimi personal, 74 penale themeli, dhe 58 urdhëra ekzekutimi ;
- **Për vitin 2015** (01.01.2015-31.12.2015), ka përfunduar 453 çështje nga të cilat ; 84 civile themeli, 66 çështje familjare, 24 kërkesa civile, 18 kërkesa penale, 43 masa sigurimi personal, 78 penale themeli, 140 urdhëra ekzekutimi ;
- **Për vitin 2016** (01.01.2016-7.10.2016), ka përfunduar 344 çështje, nga të cilat ; 48 civile themeli, 68 çështje familjare, 19 kërkesa civile, 24 kërkesa penale, 69 masa sigurimi personale, 72 penale themeli dhe 44 urdhëra ekzekutimi.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, me qëllim përcaktimin e rendimentit, do t'i referohemi deklarimit të gjyqtarës, të bërë në formularin e vetvlerësimit profesional, bashkëngjitur të cilit është dhe vërtetimet me nr.264 prot., datë 21.10.2016 si dhe me numër 51 prot., datë 24.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, sipas të cilit rezultoi se asaj i janë caktuar gjatë periudhës 01.01.2013- 18.11.2016, 996 çështje dhe

ka përfunduar 917 çështje. Nga llogaritja e numrit të çështjeve të caktuara me numrin e çështjeve të përfunduara me vendim, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjatë kësaj periudhe është 94.9 %. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, ky rendiment pikëzohet me 8 pikë (Mbi 93-99%).

Ndërsa sipas raportit për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në deklarinimin e bërë nga vetë gjyqëtarja është llogaritur me 93,2 %”, përqindje e cila gjithashtu pikëzohet me 8 pikë.

Sipas vërtetimit me nr.264 prot., datë 21.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton se gjatë periudhës qershor – korrik 2015 gjyqtarja ka qenë me leje nga ish KLD, për arsye studimore.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve, sipas pikës 3 shkronja “g”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështjes civile me palë kundërshtare.

Ndërsa në pikën 3, shkronja “k” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se: *“Kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese minimale respektivisht në masën e 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate”.*

Referuar të dhënave statistikore, rezultoi se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (08.10.2013-08.10.2016), 1154 çështje, nga të cilat 608 çështje me palë kundërshtare dhe 546 çështje pa palë kundërshtare (kërkesa penale dhe civile, duke e tejkalluar standardin sasior me vetëm 8 çështje.

Por gjatë periudhës së vlerësimit, për periudhën 08.10.2013 deri rreth fundit të muajit korrik 2014 (23.07.2014), gjyqtarja ka ushtruar edhe detyrën e kryetares së gjykatës, pra për një periudhë prej rreth 9 muaj e 15 ditë, çka nënkupton se gjatë kësaj periudhe duhet të kishtë një pjesmarrje në short jo më pak se 40 % të çështjeve (por nga të dhënat statistikore nuk duket se gjatë kësaj periudhe gjyqtarja është vetpërfunduar nga shorti), apo të ketë gjykuar rreth 60 çështje me palë kundërshtare gjatë periudhës prej 9 muajsh dhe gjatë vitit të plotë rreth 100, duke e tejkalluar standardin sasior për këtë periudhë me 100 çështje me palë kundërshtare.

Gjithashtu, ka rezultuar se gjatë periudhës qershor – korrik 2015 gjyqtarja ka qenë me leje studimore, të miratuar nga ish KLD- dhe gjatë kësaj periudhe ajo nuk ka dhënë asnjë vendim gjyqësor, fakt që rezulton edhe nga të dhënat statistikore. Për pasojë gjatë këtij viti, gjyqtarja duhet të përfundonte në minimum jo më pak se 155 çështje me palë kundërshtare, ndërsa ajo ka përfunduar 228 çështje me palë kundërshtare, duke e tejkaluar kështu standardin minimal me 74 çështje apo me 47 %.

Për pasojë, vlerësimi i plotësimit të standardit sasior do të bëhet për çdo periudhë më vete, pasur parasysh se standardi sasior ndryshon në periudha të ndryshme.

Për vitin 2014, kur gjyqtarja ka punuar për gati gjysmën e vitit ka ushtruar dhe funksionin e kryetares së gjykatës, çka nënkupton një ngarkesë sasiore gjatë vitit prej jo më pak se 140 çështje themeli me palë kundërshtare, rezulton se ka përfunduar 168 çështje themeli, me palë kundërshtare, duke tejkaluar kështu standardin sasior gjatë këtij viti me 28 çështje. Nga të dhënat statistikore rezultoi se gjatë vitit 2015, gjyqtarja ka përfunduar 228 çështje me palë kundërshtare, duke e tejkaluar standardin sasior gjatë këtij viti me 28 çështje. Po të marrim në konsideratë kohën gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me leje nga ish KLD, rezulton se e ka tejkaluar standardin sasior me 74 çështje. Për vitin 2016, e cila përfshin një periudhë thuhet 8 muaj, ka përfunduar 188 çështje me palë kundërshtare, ndërkohë duhet të përfundonte rreth 150 çështje për këtë periudhë, duke qenë mbi standardin minimal sasior me 38 çështje.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 94.9 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 8 pikë, pasur parasysh faktin se gjyqtarja ka tejkaluar në çdo vit standardin minimal të miratuar, me rreth 100 çështje për tre vitet e plota të punës, numrin e lartë të kërkesave penale e civile të shqyrtuara gjatë periudhës së vlerësimit prej 546 kërkesa, të cilat rrisin dukshëm ngarkesën e gjyqtares (pasur parasysh se disa kanë qenë edhe me afat ligjor, psh urdhërat e ekzekutimit, apo masat e sigurimit personal), faktin se për një periudhë gjyqtarja ka ushtruar edhe funksionin e kryetares së gjykatës, dhe për vitin 2015 ka qenë me leje studimore për një periudhë rreth 2 muaj, vlerësohet se mund të arrihet në një pikëzim më të lartë se ai që i përket rendimentit të gjyqtares, duke u pikëzuar me 10 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se në çdo vit e ka tejkaluar standardin minimal sasior dhe ngarkesa e saj në punë, referuar kushteve të punës ka qenë e lartë.*

2.A.D. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, është konstatuar se gjyqtarja {...}, i kushton rëndësi arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve, për të mos pasur vonesa dhe brenda afateve ligjore. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej saj pas 1 dite (shih dosjen 5) pas 2 ditëve (shih dosjet 2 e 3) pas 10 ditëve (shih dosjen 1) dhe pas 15 ditëve (shih dosjen 4). Pra vetëm një prej dosjeve, është dorëzuar në kryesekretari jashtë afatit ligjor”.*

Kodi i Procedurës Penale në fuqi, para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk kishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore, kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308/2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Dosjet e përzgjedhura me short, të administruara gjatë procesit të rivlerësimit⁵³, janë dorëzuar të arsyetuara, si më poshtë :

- (i) Dosja 1 - Çështja civile (zgjidhje martesë) përfunduar me vendimin nr.352, datë 06.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 16.05.2016, pra 10 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (ii) Dosja 2 - Çështja civile (civile themeli) përfunduar me vendimin nr. 70, datë 05.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 07.02.2014, pra 2 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (iii) Dosja 3 - Çështja penale (penale themeli), përfunduar me vendimin nr. 4, datë 15.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 17.01.2014, pra 2 ditë pas shpalljes, brenda afatit 10 ditor të ankimit, sipas nenit 415 të K.Pr.Penalë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016;
- (iv) Dosja 4- Çështja penale (penale themeli), përfunduar me vendimin nr. 101, datë 02.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 17.03.2015, pra 15 ditë pas shpalljes, jashtë afatit 10 ditor të ankimit sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016;
- (v) Dosja 5 – Çështja administrativo penale, përfunduar me vendimin nr. 302, datë 26.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 27.11.2015, pra 1 ditë pas shpalljes, brenda afatit 10 ditor të ankimit, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016;

Ndërsa 6 (gjashtë) dosjet e përzgjedhura me short, për efekt të këtij procesi vlerësimi (gradim), janë dorëzuar të arsyetuara, si më poshtë :

- (vi) Dosja 6 (1) - Çështja civile (zgjidhje martesë) përfunduar me vendimin nr. 113 (249), datë 21.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 25.02.2014, pra 4 ditë pas shpalljes, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (vii) Dosja 7 (2) - Çështja penale (penale themeli), përfunduar me vendimin nr. 225, datë 21.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 27.11.2013, pra 6 ditë pas shpalljes, brenda afatit 10 ditor të ankimit, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016;
- (viii) Dosja 8 (3) - Çështja civile (civile themeli), përfunduar me vendimin nr. 712, datë 11.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 21.11.2014 - pra 10 ditë pas shpalljes, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (ix) Dosja 9 (4) - Çështja penale (penale themeli), përfunduar me vendimin nr. 382, datë 16.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 19.12.2014, pra 3 ditë pas shpalljes, brenda afatit 10 ditor të ankimit, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016;
- (x) Dosja 10 (5) - Çështja civile (zgjidhje martesë), përfunduar me vendimin nr. 649, datë 22.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 03.10.2016, pra 11 ditë pas shpalljes, jashtë afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile, duke e tejkalluar këtë afat me 1 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm;
- (xi) Dosja 11 (6) - Çështja penale (penale themeli), përfunduar me vendimin nr. 391, datë 16.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është dorëzuar në datën 20.11.2015, pra 4 ditë pas shpalljes, brenda afatit 10 ditor të ankimit, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për çështjet e kategorisë “Penale” është 6 ditë; për kategorinë “Civile

⁵³ Sipas Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit

themeli” është 6 ditë; për kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtare” është 8,3 ditë dhe për kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale” është 1 ditë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar për të gjitha kategoritë për të cilat ka të dhëna, rezulton të jetë “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, që sipas Metodologjisë së pikëzimit, pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve

2.B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.A. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në 2 çështjet civile të vëzhguara, ajo ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore (shih dosjet 1 e 2). Në këto 2 raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me proces verbal të rregullt nga pikëpamja formale. Në 2 çështjet civile, gjykimet kanë përfunduar me 5 e 6 seanca. Ndërsa 3 çështjet penale të vëzhguara, dy nga të cilat lidhen me vepra penale krime, kanë përfunduar me 4 dhe 13 seanca (shih dosjet 3 e 4), ndërsa tjetra, kërkesë administrativo penale, ka përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 5). Konkretisht janë vëzhguar 29 seanca gjyqësore, nga të cilat 21 kanë qenë produktive. Pengesë në 8 seanca joproduktive kanë qenë paraqitja e të paditurit pa dokument identifikimi (1 seancë); mosparaqitja e paditëses (1 seancë); njoftimi i Avokaturës së Shtetit (1 seancë); kërkesa e paditësit për shtyrje (1 seancë) dhe mosparaqitja e mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri (4 seanca). Gjatë gjykimit, subjekti i rivlerësimit identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit

gjqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare të palëve e gjer tek shpallja e vendimit”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 (dhjetë) prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, pasi dosja me nr. 5, i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

Dosja 1 - Çështja civile (familjare) nr. 348 (33) regjistri, datë regjistrimi 18.01.2016, përfunduar me vendimin nr. 352, datë 06.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jenë zhvilluar 4 seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të paraqitjes së palës së paditur pa dokument identifikimi dhe depozitimit të palës paditëse kërkesë për shyrjen e seancës.

Dosja 2 - Çështja civile nr. 125/1063 (1288) regjistri, datë regjistrimi 04.11.2013, përfunduar me vendimin nr. 70, datë 05.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka rezultuar joproduktive, për shkak të dhënies kohë palës paditëse të përfaqësohet me avokatin e zgjedhur.

Dosja 3 - Çështja penale nr. 307/40 (612) regjistri, datë regjistrimi 27.11.2013, përfunduar me vendimin nr. 4, datë 15.01.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jenë zhvilluar 4 seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të njoftimit të mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata për të pandehurin, dhënien kohë mbrojtësit për t’u njohur me aktet, dhënien kohë palëve për të përgatitur diskutimin përfundimtar.

Dosja 4 – Çështja penale nr. 4/229 regjistri, datë regjistrimi 29.05.2014, përfunduar me vendimin nr. 101, datë 02.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jenë zhvilluar 13 seanca gjyqësore, nga të cilat 5 (pesë) seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të kërkesës së të pandehurit për t’u mbrojtur nga avokati i zgjedhur prej tij, për shkak të njoftimit të mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata për të pandehurin, dhënien kohë mbrojtësit për t’u njohur me aktet, për thirrjen e dëshmitarëve, dhënien kohë prokurorit për të mbajtur qëndrim në lidhje me kërkesën e mbrojtjes për kryerjen e një riekspertimi, mosparaqitje e ekspertit dhe njoftimi me detyrim i tij, dhënien kohë ekspertit për të përgatitur shtesë të aktit të ekspertimit, dhënien kohë palëve për të përgatitur diskutimin përfundimtar me shkrim.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Dosja 6 (1) - Çështja civile (familjare) nr. 108-237 regjistri, datë regjistrimi 06.02.2014, përfunduar me vendimin nr. 113 (249), datë 21.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jetë zhvilluar 1 seancë gjyqësore.

Dosja 7 (2) - Çështja penale nr. (590) 293 regjistri, datë regjistrimi 19.11.2013, përfunduar me vendimin nr. 225 (1961), datë 21.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jetë zhvilluar 1 seancë gjyqësore.

Dosja 8 (3) - Çështja civile nr. 804-(566) regjistri, datë regjistrimi 24.07.2014, përfunduar me vendimin nr. 712 (1708), datë 11.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jenë zhvilluar 5 seanca gjyqësore, ku gjykimi është ndërprerë me qëllim marrjen e provave tek pala e paditur, dhënien kohë palëve për të përgatitur diskutimin përfundimtar me shkrim, dhënien kohë palëve pas riçeljes së hetimit gjyqësor për të mbajtur qëndrim me provat e reja.

Dosja 9 (4) - Çështja penale nr. (760) 478 regjistri, datë regjistrimi 05.12.2014, përfunduar me vendimin nr. 382 (1973), datë 16.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jetë zhvilluar 1 seancë gjyqësore.

Dosja 10 (5) - Çështja civile (familjare) nr. 405-606 regjistri, datë regjistrimi 09.05.2016, përfunduar me vendimin nr. 649 (1492), datë 22.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore, ku gjykimi është ndërprerë për mosmarrje dijëni rregullisht të palës së paditur dhe për përgatitjen e aktit të ekspertimit nga psikologu.

Dosja 11 (6) - Çështja penale nr. 632 (395) regjistri, datë regjistrimi 17.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 391 (2360), datë 16.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton të jenë zhvilluar 4 seanca gjyqësore, ku gjykimi është ndërprerë për t'u paraqitur mbrojtësi i zgjedhur i të pandehurit, për t'u dhënë kohë palëve për përgatitjen me shkrim të konkluzioneve përfundimtare.

Gjyqtarës {...} i janë evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik dy çështje për të cilën ka të dhënë lidhur me këtë tregues, konkretisht:

- *Ankesa që i përket çështjes penale, të regjistruar në datë 23.11.2012, që i përket palës kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt gjykimin e të pandehurit L.S., i akuzuar për veprën penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr. 169, datë 02.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Nga përmbajtja e relacionit për shqyrtimin e kësaj ankese, rezulton se për përfundimin e gjykimin të kësaj ankese janë zhvilluar 21 seanca gjyqësore. Referuar datës së vendimit, rezulton se çështja nuk i përket periudhës së vlerësimit e për pasojë nuk do të merret në konsideratë për efekt vlerësimi në këtë periudhë.*

- *Ankesa që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 06 datë 08.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile me objekt "Pushimin e cënimit të së drejtës së përdorimit të lirë të sendit, lirimim e banesës dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar deri në momentin e lirimimit të banesës", e cila rezulton të jetë shortuar pranë gjyqtarës në datë 18.10.2014. Nga përmbajtja e relacionit për shqyrtimin e kësaj ankese rezulton se për përfundimin e gjykimin të kësaj ankese janë zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 24 seanca gjyqësore, nga të cilat rezulton se : "4 seanca janë shtyrë për marrjen e një fashikulli gjyqësor pranë gjykatës; 8 seanca janë shtyrë për të njoftuar ekspertin, në vijim grupin e ekspertëve ku është kërkuar dhe akt ekspertimi shtesë; 2 seanca janë shtyrë për shkak se pala e paditur ka kërkuar të përfaqësohet me avokat; 1 seancë është shtyrë për t'u diskutuar akti i ekspertimit; 1 seancë është shtyrë për t'u njoftuar grupi i ekspertëve, pasi është pranuar kërkesa e palës paditëse për ekspertim me grup ekspertësh; seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe të detyrueshme procedurale, diskutimi i aktit të ekspertimit, konkluzionet përfundimtare, dhënia e vendimit përfundimtar. Referuar raportit të verifikimit të ankesës, rezulton se është arritur në përfundimin se ; shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë për arsye objektive, dhe se gjyqtarja në asnjë rast nuk është bërë shkak për shtyrjen e seancës. Çështja ka qenë relativisht e ndërlikuar, pasi pretendohet për pavlefshmërinë e procedurës së privatizimit të një objekti shtetëror, ku duhej të administrohej kjo procedurë nga institucionet e tjera, procedurë e cila ka detyruar*

gjykatën të shtyjë seancën disa herë. Edhe kryerja e ekspertimit, më tej me grup ekspertësh, dorëheqja e ekspertëve, përgatitja e aktit, kanë marrë një periudhë relativisht të gjatë kohore, duhet përjashtuar periudha e lejes vjetore të muajit gusht (1 muaj) gjatë periudhës së gjykimit si dhe fakti se janë të përfshira disa festa zyrtare ndër to dhe ato të fundvitit, apo ditët e mbartjeve të dosjeve në fillim të çdo viti referuar praktikave të gjykatave. »

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (*penale themeli dhe civile themeli*) varion nga 1 deri në 24 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 10 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përjashtuar seancat përgatitore), 4.6 seanca gjyqësore në çështje penale themeli dhe 2 seancë gjyqësore në çështjet familjare (duke përjashtuar seanca e pajtimit). **Në total numri mesatar i seancave është 5.5 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.** Në numrin mesatar prej 5.5 seancave ka ndikuar vetëm çështja civile e referuar nga ish Inspektoriat i KLD, në të cilën janë planifikuar 24 seanca gjyqësore. Kështu, po të heqim nga llogaritja këtë çështje, rezulton se numri mesatar i seancave për 10 çështjet e përzgjedhura me short është 3.7 seanca.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim (çështje civile dhe penale themeli me palë), si dhe një çështje civile të verifikuar për shkak ankese nga Inspektoriat i ish KLD, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Në çështjet penale, caktimi i datës së seancës, si dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët të cilave iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: *njoftimi i mbrojtësit të të pandehurit, njoftimi dëshmitarëve në procesin penal, njoftimi i ekspertit, dhënia kohë ekspertit për t'u përgatitur në lidhje me pyetjet dhe pretendimet e parashtruara nga palët, marrje e informacionit dhe provave nga të tretët, dhënia kohë palëve për t'u përgatitur me shkrim për konkluzione përfundimtare etj.*

Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, por edhe në çështjet civile konstatohet se gjyqtarja cakton përgjithësisht seanca të afërta në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 1 muaj larg. Konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht. Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes.

Referuar sa më sipër, nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short⁵⁴ si dhe një çështje të referuar për efekt vlerësimi, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet

⁵⁴ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse”.

me palë kundërshtare është 5.5 seanca, por në kushtet kur gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duhet të pikëzohet me 15 pikë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është shumë e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë.*

2.B.B. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit {...}, ka aftësi për planifikimin dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në 2 çështjet civile të vëzhguara, ajo ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore (shih dosjet 1 e 2). Në këto 2 raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me proces verbal të rregullt nga pikëpamja formale. Gjatë gjykimit, subjekti i rivlerësimit identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare të palëve e gjer tek shpallja e vendimit. U konstatua se në dy gjykimet penale të themelit, vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë brenda afatit maksimal të 10 ditëve, të parashikuar nga neni 333/1 i K.Pr.Penale dhe seanca e parë është caktuar pas më shumë se 10 ditë siç është parashikuar nga neni 333/2 i K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore janë caktuar gjithmonë duke respektuar afatin 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale (shih dosjet 3 e 4).”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 (dhjetë) prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje të gjitha çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose brenda afatit ligjor, pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara, janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen në mënyrrë të përmbledhur me shkrim nga sekretaria gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara nga ligji për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me pak vonesa deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohen edhe disa seanca (11 seanca)⁵⁵ të filluara me më shumë se 18

⁵⁵ Dosja 1 – seanca e datës 02.03.2016 ka filluar 25 minuta me vonesë për shkak të zgjatjes tej afteve të planifikuara me gjykimet e tjera; Dosja 2 – seanca e datës 27.01.2014 ka filluar 22 minuta me vonesë për shkak të zgjatjes tej afteve të planifikuara me gjykimet e tjera; Dosja 3 – seanca e datës 09.01.2014 ka filluar 18 minuta me vonesë për shkak të mungesës së sekretarisë gjyqësore; Dosja 4 – seanca e datës 15.09.2014 ka filluar 21 minuta me vonesë për shkak të shqyrtimit të kërkesë mase sigurimi nga gjyqtarja; seanca e datës 22.10.2014 ka filluar me 20 min vonesë; seanca e datës 27.11.2014 ka filluar me 23 min vonesë; seanca e datës 10.12.2014 ka filluar me 26 min vonesë në pritje të paraqitjes së dëshmitarëve; seanca e datës 22.12.2014 ka filluar me 33 min vonesë për shkak të zgjatjes tej afteve të planifikuara me gjykimet e tjera; seanca e datës 16.01.2015 ka filluar me 58 min vonesë për shkak se prokurori ndodhej në disa veprime të ngutshme; Dosja 8 (3) – seanca e datës 14.10.2014 ka filluar me 27 min vonesë; seanca e datës 23.10.2014 ka filluar me 34 min vonesë;

minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në tërësi, pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuarra (26 % e seancave rezultojnë të filluara me vonesë) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relativitetit të gjyqtarëve lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo në pritje të paraqitjes së përfaqësuesit të organit të akuzës, dëshmitarëve në çështjet penale, si dhe kur gjykimet e mëparshme të ditës, kanë zgjatur tej afatit të planifikuar.

KONKLuzioni

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Gjithashtu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.c.a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, u konstatua se ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur proces verbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile (shih dosjet 1 e 2) ose ato penale (shih dosjet 3, 4 e 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha proces verbalët, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të

administruara në dosje, rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera konform nenit 118 të K.Pr.Civile. Të gjitha procesverbalet gjyqësore rezultojnë të nënshkruara nga sekretaria gjyqësore dhe nga gjyqtarja, konform kërkesave të nenit 118 të K.Pr.Civile dhe nenit 345 të K.Pr.Penale. Proces verbali gjyqësor në formatin letër dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në 8 raste të çeljes së seancës gjyqësore me vonesë mbi 15 minuta, rezulton se në 7 prej tyre është pasqyruar në proces verbal shkaku i vonesës (shih dosjet 2, 3 e 4) ndërsa vetëm në një rast nuk është dokumentuar shkaku i vonesës (shih dosjen 4). Konstatohet se nga 29 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të dokumentuara me regjistrim audio 26 prej tyre, në përputhje të plotë me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e më pas aktet e gjykatës. Gjithashtu, të gjitha dosjet rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë, në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes, në çështjen penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Po ashtu, renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarës për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve, provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, diskutimet përfundimtare të palëve, etj). Nuk konstatohet mungesa e dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit

99	Shkëlqyeshëm
----	--------------

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2006 dhe është emëruar gjyqtare.... Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”.*

3.A.A. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të ish KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në ankesat e arkivuara nga ish Inspektorati i KLD-së nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues

rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

3.B. Integriteti i gjyqtares

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se; “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
 - Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
 - Të dhënat për masa disiplinore;
 - Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI-së pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, në periudhën e vlerësimit, të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren janë paraqitur gjithsej 7 ankesa në Inspektoratin e ish KLD-së. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Në vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer, konkludohet se : “..Nga vlerësimi në tërësi i këtij kriteri ka rezultuar se nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën Vetting

nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklarim të rremë”⁵⁶.

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 688, datë 21.07.2023, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarës, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, duke konkluduar se: *“Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit znj. {...}, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e Ligjit 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar”⁵⁷.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C. Paanësia e gjyqtarës.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale, me pasojë cënimin e parimit të gjykatës së paanshme”.*

3.C.A. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

⁵⁶ Në faqen 20 të vendimit

⁵⁷ Në faqen 21 të vendimit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar akteve burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Për gjyqtaren {...} në asnjë rast, prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve”*.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës. Në këto kushte, referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit të tij është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë, të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Prandaj, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, duhet të konsiderohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës” është “I pakonsiderueshëm”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A. Aftësia e komunikimit.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”*.

4.A.A. Komunikimi i qartë dhe transparent.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është shumë e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët apo përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve, është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “I lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. Aftësia për të bashkëpunuar.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 6 nga 8 rastet, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale”.

4.B.A. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si

dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : “*Subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të gjyqtarës së shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 23 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 41 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarës të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale.*

Subjekti i rivlerësimit {...} ka deklaruar se ka marrë pjesë edhe në aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, duke bashkëlidhur certifikatat me temë: “Administration of Justice”, zhvilluar në Hagë-Hollandë në periudhën 07.11.2011 deri më 18.11.2011; Trajnim i zhvilluar nga Departamenti i Drejtësisë SHBA dhe Ambasada Britanike më datë 11.04.2014 ; Trajnim i zhvilluar nga Interpol në Tiranë, më datë 24-26 qershor 2014 ; Takim i zhvilluar në Prishtinë-Kosovë nga Instituti ALB-Shkenca, me temë « Juridiksioni gjyqësor civil sipas të drejtës procedurale civile dhe administrative » më datë 29-31 gusht 2014 ; Takim i zhvilluar në shkup-Maqedoni nga Instituti ALB-Shkenca me temë « Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm në procesin civil » më datë 28-30 gusht 2015.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe botime si : Botim në revistën “tribunë Juridike” nr. 58 të vitit 2006 të artikullit me titull “Ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes nga prokurori”; Botim tek Revista “Jeta Juridike” nr. 4 e vitit 2014 të artikullit me titull “Pengesat specifike të njerëzve në nevojë në realizimin e të drejtave të tyre në

veprimtarinë e gjykatave” dhe Shkrim me titull “Juridiskioni gjyqësor civil sipas së drejtës procedurale civile dhe administrative”.

4.C.A. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit si dhe vërtetimit me nr. 412/1 prot., datë 13.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016, rezulton se gjyqtarja, ka qenë pjesëmarrëse në 20 (njëzet) aktivitete trajnuese të organizuara nga kjo shkollë, në cilësinë e pjesëmarrëses, gjithsej 36 ditë. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja është angazhuar si lehtësuese dhe moderatore në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në 3 aktivitete, gjithsej 5 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9⁵⁸ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përllorë 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 46 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Gjithashtu, gjatë periudhës së vlerësimit rezultoi se ajo ka marrë pjesë 5 aktivitete të tjera të jashtë Shkollës së Magjistraturës, të zhvilluara në 19 ditë pjesëmarrje në trajnim dhe konference shkencore.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit

⁵⁸ Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përllorë 1 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë si lehtësues të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përllorë 1 ditë si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare”.

gjqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.

Aktualisht, në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve⁵⁹. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se *gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli. Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.*

Referuar sa më sipër, pavarësisht se Ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të Ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrje.

Sa më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarës {...} në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë me 20 pikë. Ndër të tjera rezultoi se ajo ka marrë pjesë në 23 aktivitete të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës, të zhvilluara për 46 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

⁵⁹ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se : *”1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuar nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”*

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penal, gjithsej 23 aktivitete të zhvilluara për 46 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare. Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë edhe në aktivitete jashtë Shkollës së Magjistraturës.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë dhe pwr kwtw arsye vlerwsohet dhe pikwzohet me 20 pikë.

4.C.B. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, rezulton se gjyqtarja është angazhuar si lehtësuese dhe moderatore në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në 3 aktivitete, të zhvilluara në 5 ditë trajnimi.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi, të angazhimit në këto veprimtari. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtaren gatishmërinë për të kontribuar si lehtësuese në trajnimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, prandaj vlerësohet se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në 3 aktivitete trajnuese si lehtësuese dhe moderatore në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.C. Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtarja lidhur me këtë tregues së bashku me formularin e vetëvlerësimit profesional rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore, fjalime publike, prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit etj. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka deklaruar dhe rezulton të ketë marrë pjesë në këto aktivitete;

- 1) Konferenca shkencore, e zhvilluar më datë 29-31 gusht 2014 në Prishtinë-Kosovë nga Instituti ALB-Shkenca, në të cilën gjyqtarja ka prezantuar punimin me temë « Juridiksioni gjyqësor civil sipas të drejtës procedurale civile dhe administrative », botuar në Librin e përmbledhjes me ISBN / 978-9951-518-11, më datë 29 - 31 gusht 2014 ;
- 2) Konferenca shkencore, e zhvilluar më datë 28 - 30 gusht 2015 në Shkup - Maqedoni nga Instituti ALB-Shkenca, në të cilën gjyqtarja ka prezantuar punimin shkencor, me temë « Gjykimi brenda një afati të arsyeshem në procesin civil », i botuar në librin e përmbledhjes së konferencës.

Gjyqtarja ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se gjatë vitit 2011-2014 si dhe 2016 është angazhuar edhe në mesimdhënie si pegadoge, pranë Universitetit Privat "Albanian University, por nuk ka paraqitur akte provuese lidhur me këtë angazhim.

Lidhur me këtë tregues në Metodolinë e Pikëzimit parashikohet se:”Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit;

aktivitete mësime të mëdha për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshme me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë gjyqtarja {...} të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.Ç. Publikimet ligjore akademike.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, rezultojnë që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Konkretisht, gjyqtarja ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit si dhe ka depozituar prova në lidhje me angazhimin e saj në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, gjatë periudhës së vlerësimit, si:

- Botimin me titull " *Pengesat specifike të njerëzve në nevojë në realizimin e të drejtave të tyre në veprimtarinë e gjykatave* ", botuar në Revistën “Jeta Juridike” nr. 4 e vitit 2014, me ISBN.
- Botim me titull “*Juridiskioni gjyqësor civil sipas së drejtës procedurale civile dhe administrative*”, botuar në Revistën Shqiptare për Studime Ligjore, Vol. 8 me ISSN.

- Artikull shkencore « Juridiksioni gjyqësor civil sipas të drejtës procedurale civile dhe administrative», botuar në Librin e përmbledhjes së Konferencës shkencore, me ISBN ; 978-9951-518-11, më datë 29 - 31 gusht 2014 .
- Artikull shkencore, me temën “Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm në procesin civil », i botuar në librin e përmbledhjes së konferencës shkencore, zhvilluar më datë 28 - 30 gusht 2015 në Shkup - Maqedoni nga Instituti ALB-Shkenca.

Gjyqtarja ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit si dhe ka depozituar prova në lidhje me angazhimin e saj në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, gjatë karrierës së saj, të cilat nuk I përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016, konkretisht botimin me titull “Ankimi kundër vendimit të pushimi të çështjes nga prokurori”, botuar në revistën “Tribuna Juridike”, botim i vitit 2006. Por duke qenë se ky publikim është jashtë periudhës së vlerësimit tetor 2013- tetor 2016, nuk do të merren në konsideratë për këtë periudhë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit 2013- 2016 dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 5 pikë për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

PWRCAKTIMI I NIVELIT TW VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	99	Shkëlqyeshëm

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	399	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR